

# Masat që merren nga 6 janari

**Qeveria ka vënë rregulla për të ndaluar koronavirusin. Rrespektoji rregullat! Kështu ti nuk sëmuresh, apo nuk mund të sëmuresh asnjëri. Policia mund të të kontrollojë.**

Vini re: Disa qytete/bashki dhe komuna kanë rregulla më të rrepta. Shiko faqen e internetit të qytetit/bashkisë apo të komunës.

## Këshilla për një vjeshtë dhe dimër të sigurtë.

---

- Vaksinohu!
- Mbaj 1,5 metra distancë nga personat e tjerë!
- Mbaj/vendos një maskë për gojë!
- Ajros mirë : hapi dritaret!
- Bëj rregullisht një test që bëhet vetë!
- Bëj kujdes tek personat e rrezikueshëm! Për shembull: njerëzit më të moshuar se 65vjeç, njerëzit me probleme të zemrës, mushkërive apo veshkave dhe njerëzit që janë të ndjeshëm për infeksione.

## Covid Safe Ticket (CST) Bileta e sigurisë për kovid

---

- Të nevojitet një Covid Safe Ticket për të shkuar në disa vende, për shembull:
  - Në kafe apo në restorant.
  - Në qendrat e fitness-it.
  - Në mbledhje apo evente/aktivitete me më shumë se 50 persona në ambientet e brendshëm apo 100 persona përjashta.
- Covid Safe Ticket tregon që ti
  - Ke më tepër se 14 ditë që je vaksinuar plotësisht
  - Ke pasur një test negativ për koronavirus (ka maksimumi 72 orë)
  - Ke kaluar kohët e fundit kovidin (nuk ka më tepër se 180 ditë)
- Covid Safe Ticket tënde e gjen në [www.covidsafe.be](http://www.covidsafe.be) ose me anë të aplikacionit CovidSafeBE.

## Maskat për gojë

---

- Nëse ke moshë më të madhe se 6 vjeç, atëherë maska për gojë është e detyrueshme në vendet publikë. Për shembull:
  - Në dyqan
  - Në mjetet e transportit publik
  - Në institucionet e kujdesit: për shembull në spital apo qendër strehimi me kujdes/azile pleqësh
  - Tek berberi/floktorja apo tek specialistët e bukurisë
  - Në një sallë të teatrit, sallë të koncerteve, qendër/sallë sporti, fitness...

- Në bibliotekë
- Gjatë një shërbimi fetar
- Gjatë evenimentëve publikë, për shembull një ndeshje sporti apo një koncert.
- Gjatë një feste martese ose varrimi, me më shumë se 50 persona në ambientet e brendshëm apo 100 persona përjashta
- Në kafe apo restorant.
- Në shkollë.

## Punë

---

- Puno nga shtëpia! Kjo është e detyrueshme.
  - Lejohet të shkosh një ditë në javë në punë. Bjer dakord me shefin tënd!
- Nëse nuk mund të punosh nga shtëpia, atëherë të jepet një vërtetim nga shefi yt. Ndiqi rregullat në punën tënde!
- Nëse ke pyetje, merr informacione nga shefi yt.

## Dyqanet

---

- Dyqanet janë hapur.
  - Shkoni në dyqan maksimumi 2 persona bashkë! Kjo nuk vlen për fëmijët nën 13 vjeç (nuk llogariten).
- Ka tregje (tregjet hapur).
- Dyqani i natës është hapur deri në ora 23:00.
- Berberët/floktoret dhe profesionet e tjerë jomjeksor të kontaktit (të afërt) janë hapur. Për shembull : pedikyrë, specialistët e bukurisë.
- Mbaj/vendos një maskë për gojë!

## Hotel, restorant, kafe

---

- Kafetë dhe restorantet janë hapur deri në ora 23:00
  - Ti duhet të kesh një Covid Safe Ticket. Covid Safe Ticket tënde e gjen në [www.covidsafe.be](http://www.covidsafe.be) ose me anë të aplikacionit CovidSafeBE.
  - Mbaj/vendos një maskë për gojë! Nëse je ulur në tavolinë, atëherë lejohet t'a heqësh maskën tënde për gojë.
  - Lejohet të ulen në një tavolinë bashkë maksimumi 6 persona.

## Kontakt social

---

- Lejohet të presësh njerëz në shtëpinë tënde.
  - Është mira t'a bësh këtë përjashta.

- Bëj një test që bëhet vetë para se të ftosh njerëz! Një test që bëhet vetë mund t'a blesh në farmaci.
- Është mira të ftosh pak njerëz.
- Nëse organizon një festë private, atëherë atë mund t'a bësh vetëm në shtëpi dhe jo në një vend tjetër, për shembull në një sallë festash. Fto pak njerëz ose bëje këtë gjë përjashta!
- Por një festë martesë apo një varrim lejohet të bëhet në një vend tjetër. Ndiq këto rregulla!
  - Lejohet të ulen në një tavolinë bashkë maksimumi 6 persona.
  - Nëse janë më shumë se 50 persona në ambientet e brendshëm apo më shumë se 100 persona përjashta atëherë:
    - Mbaj/vendos një maskë për gojë!
    - Ti duhet të kesh një Covid Safe Ticket. Covid Safe Ticket tënde e gjen në [www.covidsafe.be](http://www.covidsafe.be) ose me anë të aplikacionit CovidSafeBE.

## Koha e lirë

---

- Aktivitetet/eventimentët apo shfaqet lejohen të zhvillohen në ambientet e brendshëm dhe përjashta. Për shembull: teatër dhe koncerte.
- Aktivitetet e organizuar, si për shembull një klub apo shoqatë, lejohen të zhvillohen vetëm përjashta. Por, me një klub apo shoqatë, lejohet të bëhet sport në ambientet e brendshëm.
- Qendrat e fitnesit, qendrat e wellnesit dhe pishinat janë hapur.
- Kinematë, bibliotekat dhe muzetë janë hapur.
- Shërbimet fetare lejohen të bëhen.

### Çfarë nuk lejohet?

- Diskotekat dhe sallat e vallëzimit janë mbyllur.
- Shumë aktivitete në ambientet e brendshëm janë të mbyllur. Për shembull: parqet e dëfrimit (lojra) në ambiente të brendshëm, sallat e bowling, pjesët për dëfrim/lojra të pishinave ...
- Në ndeshje sporti nuk lejohet të ketë publik.

### Vini re:

- Nëse shkon në një event publik në ambientet e brendshëm, atëherë
  - Lejohet të jenë maksimumi 200 persona.
  - Ti duhet të ulesh.
  - Ti duhet të mbash/vendosësh një maskë për gojë.
  - Mbaj 1,5 metra distancë nga personat e tjerë!
  - Nëse janë më tepër se 50 persona në ambientet e brendshëm atëherë ti duhet të kesh një Covid Safe Ticket. Covid Safe Ticket tënde e gjen në [www.covidsafe.be](http://www.covidsafe.be) ose me anë të aplikacionit CovidSafeBE.
- Nëse shkon në një event publik përjashta, atëherë

- Ti duhet të mbash/vendosësh një maskë për gojë.
- Mbaj 1,5 metra distancë nga personat e tjerë!
- Nëse janë më tepër se 100 persona përjashta atëherë ti duhet të kesh një Covid Safe Ticket. Covid Safe Ticket tënde e gjen në [www.covidsafe.be](http://www.covidsafe.be) ose me anë të aplikacionit CovidSafeBE.

## Çerdhe dhe shkolla

---

- Çerdhet janë hapur.
- Fëmijët mund të kthehen në shkollë. Shkolla jote të jep informacione të mëtjeshëm.
  - Fëmijët nga mosha 6 vjeç duhet të mbajnë/vendosin një maskë për gojë.
  - Nëse 4 fëmijë nga e njëjta klasë kanë koronavirus, atëherë fëmijët e klasës duhet të futen në karantinë.

## Udhëtime jashtë shtetit

---

- Është mira të mos udhëtosh jashtë Bashkimit Evropian.
- Nëse udhëton jashtë shtetit, atëherë janë 3 kode me ngjyra :
  - Kuq: rajon ose shtet ku ti ke një rrezik të madh për koronavirus. Është mira të mos udhëtosh për atje.
  - Portokalle: rajon ose shtet ku ti ke një rrezik të mesëm për koronavirus. Është mira të mos udhëtosh për atje.
  - Jeshil/ e gjelbër: rajon ose shtet ku ti ke një rrezik të vogël për koronavirus. Por ti mund të udhëtosh për atje.
  - Shiko tek faqja e internetit <https://www.info-coronavirus.be/nl/kleurcodes-per-land/>
- Shiko në [diplomatie.belgium.be](http://diplomatie.belgium.be) se cilat rregulla janë në shtetin ku ti do të shkosh!

## Nëse kthehesh nga jashtë shtetit

- Ishe në udhëtim jashtë shtetit për më gjatë se 48 orë?
  - Plotëso formularin në: <https://travel.info-coronavirus.be/nl/public-health-passenger-locator-form> para se të kthehesh në Belgjikë!
  - Nëse vjen nga një zonë e gjelbër/jeshile apo portokalle, atëherë nuk duhet të bësh test dhe nuk duhet të futesh në karantinë.
  - Vjen nga një zonë e kuqe në Bashkimin Evropian?
    - Nëse ke një çertifikatë e vaksinimit ose një çertifikatë e shërimit, atëherë ti nuk duhet të futesh në karantinë apo të bësh një test.
    - Nëse nuk ke një çertifikatë e vaksinimit ose një çertifikatë e shërimit atëherë bëj një test në ditën 1 (e parë) dhe 7 (të shtatë) pasi je kthyer në shtëpi nga udhëtimi.

- Nëse testi yt është pozitiv, është e detyrueshme të futesh 10 ditë në izolim.
- Fëmijët nën 12 vjeç nuk duhet të bëjnë test.
- Vjen nga një zonë e kuqe jashtë Bashkimit Evropian?
  - Nëse ke një çertifikatë e vaksinimit, atëherë ti duhet të bësh një test në ditën 1 ose 2 pasi je kthyer në shtëpi pas udhëtimit. Nëse testi yt është negativ, atëherë ti lejohet të dalësh nga karantina kur të marrësh rrezultatit. Fëmijët nën 12 vjeç nuk duhet të bëjnë test.
  - Nëse nuk ke një çertifikatë e vaksinimit, atëherë është e detyrueshme të futesh 10 ditë në karantinë.  
Bëj një test në ditën 1 dhe 7 pasi je kthyer në shtëpi nga udhëtimi.  
Nëse testi yt në ditën 7 është negativ, atëherë lejohet të dalësh nga karantina.
- Ka disa shtete për të cilat kjo nuk vlen. Këtë listë e gjen në <https://www.info-coronavirus.be/nl/kleurcodes-per-land/>
- Nëse vjen nga një zonë me rrezik shumë të madh, atëherë
  - Një listë të këtyre zonave e gjen në <https://info-coronavirus.be/nl/hoog-risico-landen/>
  - Nëse ky është një shtet jashtë Bashkimit Evropian atëherë :
    - Është e detyrueshme të futesh për 10 ditë në karantinë. Kjo vlen për të gjithë.
    - Duhet të bësh test në ditën 1 dhe 7 pasi je kthyer në Belgjikë.
- Nëse ky është një shtet brenda Bashkimit Evropian ose Zonës Schengen dhe :
  - Nuk ke çertifikatë vaksinimi.
    - Atëherë bëj test në ditën 1 pasi je kthyer në shtëpi. Nëse testi yt është negativ atëherë Lejohet të dalësh nga karantina. Pastaj bëj edhe një herë test në ditën 7.
    - Nëse një test është pozitiv, atëherë ti duhet detyrimisht të futesh 10 ditë në izolim.

Vini re: ty mund të të vihet një gjobë prej 250 eurosh nëse nuk e bën këtë.

**Këta rregulla janë të rëndësishëm për shëndetin e gjithësecilit. Gjithësecili duhet t'i rrespektojë ata. Faleminderit që do të bësh këtë gjë. Së bashku, ne e ndalojmë koronavirusin.**